

EPPC Albania kërkon një **Agjent Shitjesh (për tregun e Tiranës dhe Juglindjes)** për klientin e saj, i cili operon në sektorin e distribucionit & retail-it.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Viziton pikat e shitjes të zonës që mbulon sipas programit ditor;
- Prezanton në mënyrë profesionale markat që kompania tregon;
- Merr porositë, analizon nevojat e klientëve dhe bashkëpunon me ta për zgjidhjen e nevojave të tyre;
- Mirëmban klientët ekzistues dhe është në mënyrë të vazhdueshme në kërkim të klientëve të rinj;
- Analizon çmimet e konkurrentëve në treg;
- Përgatit planin ditor dhe raporton tek supervizori i tij;
- Përgatit analiza mujore për shitjet mujore duke u bazuar në target-in e tij.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Të ketë arsim të mesëm (diploma universitare përbën avantazh);
- **Eksperiencë të ngjashme pune së paku 2 vite;**
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të njohë zonën e Juglindjes (*kryesisht Elbasan, Korçë*);
- Të posedojë **leje drejtimi** dhe të ketë **disponibilitet për të udhëtuar;**
- Të ketë njohuri të mira të programit Office.

Të dhënat:

Pozicioni:	Agjent Shitjesh për Tiranën dhe Juglindjen;
Orari:	Nga e Hëna - Shtunë;
Raporton tek:	Menaxheri i shitjeve;
Pagesa:	Shumë e mirë (<i>fikse + bonuse+makinë</i>);
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	30.11.2018.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail^{it}:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë